

VENDIM
Nr. 33, datë 9.3.2016

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PHOENIX PETROLEUM” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 4, pikat 50, 105, 107; nenit 22, pika 2, germa “ç”; nenit 83, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; neneve 4, pika 1, germa “ç”; 8, 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “e” dhe nenin 10, pika 1, të Rregullave dhe Procedurave për Licencimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Licencave në sektorin e gazit natyror, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Phoenix Petroleum” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a.,

konstatoi se:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 1, germat “d”/“i”, “d”/“ii”, “d”/“iv”, “d”/“v”, “d”/“vi”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale (neni 9, pika 1, germa “e”/“i”, “e”/“ii”, “e”/“iii”, “e”/“v”, “e”/“vi”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni specifik për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa “e”/“i”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentet specifike për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa “e”/“ii”, “e”/“iii”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti